



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 25

Datë: 31. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr. 23/2023

2. Raportet e Këshillave të KQZ:

a. Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Platformës për Edukimin e Votuesve dhe Trajnim

-Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentit orientues i trajnimit të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve”

b. Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për buxhetin për blerjen e klimave

3. Te ndryshme

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr. 23/2023

Kreshnik Radoniqi, kryetar, hapi mbledhjen dhe paraqiti agjendën. Agjenda u miratua, e gjithashtu edhe procesverbali nr. 23/2023 nga mbledhja e KQZ.

2. Raportet e Këshillave të KQZ:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Platformës për Edukimin e Votuesve dhe Trajnim:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar miratimi i Platformës për Edukimin e Votuesve dhe Trajnim dhe se në kuadër të këtij moduli, është paraparë që KQZ të luaj rolin e vet informativ për edukimin dhe të drejtat e votuesve në proceset zgjedhore. Pra, edhe për pjesëmarrje në zgjedhje, por edhe për të garuar. Në mënyrë grafike, do të shpjegohen çështjet. Parashihet edhe trajnimet e administratës dhe trupave zgjedhore, dhe kjo do të na lehtësonte shumë punën në proceset zgjedhore si në rekrutim, persona të trajnuar paraprakisht. Tani, procesin do ta zhvillojmë në mënyrë digjitale. Nuk kemi bërë modifikime, kemi mbajt takim dhe kemi shqyrtuar këtë platformë dhe ne propozojmë që kjo të miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Me nëntë vota për, miratohet Platforma për Edukimin e Votuesve dhe Trajnim.

Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentit orientues i trajnimit të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve:

Arianit Elshani, tha se e kemi shqyrtuar edhe dokumentin orientues të trajnimit të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve, pra draftimin e një strategjie. E kemi shqyrtuar për disa takime nga KOZ dhe se kemi konstatuar se krahas kësaj, kemi ende në shqyrtim rregullat zgjedhore. Nuk mund të përmbillet ky dokument dhe, të mos jetë në harmoni edhe me rregullat dhe kemi konstatuar që ky dokument duhet të riemërohet. Pra, të ndryshohet gjë që, ky dokument ka rëndësi të riemërohet...

Në anën tjetër, ky dokument ka përdorë metodologji të intervistimit të zyrtarëve të lartë komunal, por edhe ka marrë për bazë statistikat e zgjedhjeve, votat e palvlefshe dhe rezultatet e zgjedhjeve... Padyshim, janë përfshirë edhe elemente të tjera. Ne, rekomandojmë që ky akvitet – dokument duhet të na orientoj ne drejt një strategjie që merr për bazë edhe ligjin e ri për zgjedhje...

Si këshill, rekomandojmë të miratohet.

Kreshnik Radoniqi: Me dhjetë vota për, miratohet ky dokument.

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për buxhetin për blerjen e klimave:

Gordana Llaban: Sot kemi mbajtur takimin e dhjetë të këshillit, dhe kemi shqyrtuar kërkesën e buxhetit për blerjen e klimave, Kjo kërkesë, ka ardhur nga sekretariati si rrjedhojë e verifikimit se kemi nevojë për blerjen e 15 klimave të reja në vlerë prej: 9 900 euro. Paratë janë të planifikuara për shpenzime, dhe kjo është bazuar në ligj dhe ne rekomandojmë për miratim...

Kreshnik Radoniqi: Me 10 vota për, miratohet kjo kërkesë e Sekretariatit.

3. Te ndryshme !